



100 Vjet Pavarësi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
MINISTRI

Adresa: bulevard "Bajram Curri", Tiranë Tel/Fax: +355 4 2362937

Nr. 3105 Prot.

Tiranë, më 2/8/2012

U R D H Ë R

Nr. 362 , datë 02/08/2012

**Për ngritjen dhe funksionimin e Task-Force
për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit
dhe të miturve nga përdorimi i alkoolit**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit Nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" nenin 25, të nenit 5 të ligjit Nr. 7643, datë 02.12.1992 "Për Shëndetin Publik dhe Inspektoratin Sanitar Shtetëror" (i ndryshuar), të nenit 19 të ligjit Nr. 9636, datë 06.11.2006 "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit", të ligjit Nr. 9518 datë 18.04.2006 "Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit" dhe të ligjit Nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative",

URDHËROJ:

1. Ngritjen e Task-Force për kontrollin e zbatimit të kërkesave ligjore që parashikohen në ligjin Nr. 9636, datë 06.11.2006 "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit", ligjin Nr. 9518, datë 18.04.2006 "Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit" në objektet e parashikuara në ligjet përkatëse në të gjithë territorin e vendit.
2. Procedura e kontrollit të Task-Forces të kryhet në përputhje me ligjin nr. 10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".
3. Task-Force kryhesohet nga Kordinatori Kombëtar për Politikën e Kontrollit të Duhanit dhe Alkoolit pranë Institutit të Shëndetit Publik dhe përbëhet nga 10 anëtarë si më poshtë: